



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 24.15.1-2012-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË AGJENCISË SHTETËRORE**  
**PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2012**

**Prishtinë, Qershor 2013**

---

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë si dhe ato të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it që ka të punësuar rreth 140 anëtarë të stafit. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe që certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare për çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP në mënyrë direkte promovojnë llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti mbajtur llogaridhënës menaxherët e organizatave individuale buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili ka bërë mbikëqyrjen e auditimit.

Opinionin dhe raportin i nxjerrë janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Vlora Mehmeti mbështetur nga Alban Beka (Udhëheqës i ekipit) dhe Arta Kryeziu.

---

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	7
2 Pasqyrat vjetore financiare.....	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak .....	11
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli .....	12
5 Sistemi i auditimit të brendshëm .....	22
6 Konkluzioni i përgjithshëm .....	23
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZAP .....	24

---

# Përmbledhje e përgjithshme

## Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave financiare vjetore (PVF-të) për vitin 2012 për Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (më tutje Agjencia). Unë do të doja të falënderoja Mbikëqyrësin Kryesor Shtetëror dhe ekipin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2012 ishte ndërmarrë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Auditimi ynë fokusohet në:

- Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF);
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit); dhe
- Sistemin e Auditimit të Brendshëm.

## Opinion

Auditori i Përgjithshëm (AP) i raporton Kuvendit për opinionin e tij në formatin e përcaktuar në Shtojcën I- Opinioni i Auditimit. Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e ZAP. Raporti i AP-së përfshin një opinion për vërtetësinë dhe drejtësinë e pasqyrave financiare.

Opinionin e AP-së është:

Pasqyrat financiare në të gjitha aspektet materiale paraqesin *një pamje të drejtë dhe të vërtetë*.

Opinionin e auditimit përfshin *Theksimin e çështjes* për shkak se Agjencia ka shpalosur vlerën e pasurive fikse në PVF, mirëpo pasuritë nuk i ka regjistruar në SIMFK. Kjo nuk ndikon në asnjë nga dy Pasqyrat Kryesore Financiare në pajtim me SNKSP (ISSAI 400 **Opinion i Pakualifikuar me Theksim të Çështjes**).

---

## **Konkluzioni i përgjithshëm**

Niveli i punës së ndërmarrë nga ana e ZAP për të përfunduar auditimin e vitit 2012 është pasqyrim i drejtpërdrejtë i cilësisë së mjedisit të kontrollit të brendshëm të implementuar nga menaxhmenti. Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Ne ishim në gjendje të kemi siguri në funksionimin efektiv të kontrolleve menaxheriale në një numër fushash të llogarive, por kemi identifikuar edhe dobësi në disa fusha të rëndësishme të menaxhimit financiar. Dobësitë janë të shpjeguara më në detaje më poshtë.

Rekomandimet e auditimit kanë për qëllim të mbështesin Agjencinë në përmirësimin e kontrolleve financiare dhe rritjen e aspekteve tjera të aktivitetit operacional.

Kemi diskutuar cilësinë e raportimit financiar të Agjencisë dhe të gjeturat e tona të detajuara të auditimit në lidhje me Pasqyrat Vjetore Financiare, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si dhe Llogaridhënien e Menaxhmentit në pjesën kryesore të këtij raporti.

### **Rekomandimet tona kryesore për Mbikëqyrësin Kryesor Shtetëror janë si në vijim:**

#### **Pasqyrat vjetore financiare**

- Të sigurojë që plani i prodhimit për pasqyrat 2013 formalisht përfshin rishikimin menaxherial të draft pasqyrave; dhe
- Të siguroj që ka regjistruar pasuritë kapitale (mbi 1000€) në SIMFK me qëllim që informatat e prezantuara në PVF 2013 të jenë të besueshme.

#### **Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli**

- Të rishqyrtoj proceset ekzistuese buxhetore për të siguruar përmirësimin e planifikimit dhe dinamikën e ekzekutimit të buxhetit. Si pjesë e këtij procesi, duhet të siguroj që rrjedha e parasë është përgatitur duke u bazuar në buxhetin fillestar të aprovuar dhe dinamika e shpenzimit të planifikohet duke u bazuar në nevojat e Agjencisë për gjatë tërë vitit;
- Të marr në konsideratë implikimet buxhetore që mund të pasojnë nga aprovimet e vendimeve menaxheriale lidhur me punën shtesë të stafit;
- Pavarësishtë faktit që procedurat e prokurimit udhëhiqen nga një autoritet tjetër, Agjencia duhet të përgatit planin fillestar dhe përfundimtar të prokurimit me qëllim të identifikimit të furnizimeve gjatë vitit;
- Të përgatit raportet për vetëvlerësimin dhe kontrolle të brendshme për të vlerësuar efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;

- 
- Të sigurojë që kontrollet në kuadër të sektorit të pagesave janë shtuar, në mënyrë që:
    - Raportet mujore mbi borxhet e agjencisë përgatiten dhe të njëjtat dërgohen në Ministrinë e Financave(MF) në baza mujore;
    - Faturat e pranuar paguhen brenda afateve të parapara me ligj; dhe
    - Shpenzimet klasifikohen dhe regjistrohen në përputhje me planin kontabël të miratuar;
  - Të rishikoj arsyet për mos mbylljen e avansit dhe të ndërmarr masa konkrete që paratë e shfrytëzuara janë arsyetuar me dokumente përkatëse dhe janë kryer procedurat e duhura për mbyllje; dhe
  - Të ndërmarr hapat konkret për çertifikimin e zyrtarit të pasurisë me qëllim që pasuritë mbi 1,000€ të regjistrohen në regjistrin kontabël (SIMFK).

#### **Sistemi i auditimit të brendshëm**

- Të shqyrtoj mundësin për lidhjen e ndonjë marrëveshje me ndonjë institucion të pavarur për shfrytëzimin e shërbimeve të auditimit të brendshëm.

Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe janë zotuar se do t'i adresojnë rekomandimet tona.

---

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Është përgjegjësi e Agjencisë të përgatis pasqyrat financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit ka reflektuar vlerësimin e rrezikut tonë të auditimit për Agjencinë. Ne kemi konsideruar të kuptuarit tonë për organizatën, deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale dhe nivelin e testimit të hollësishëm të kërkuar gjatë përcaktimit të testimeve të përgjithshme e që janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm. Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. . Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të rëndësishme** - Çështjet kryesore për vëmendjen e atyre që janë të ngarkuar me qeverisje dhe menaxhmenti i lartë e që mund të ketë potencial të rezultojë në një dobësi materiale në kontrollet e brendshme; dhe

**Të tjera** - Dobësitë e identifikuar në auditimin tonë, ku veprimi do të ofrojë potencialin për përmirësime në efikasitet dhe efektivitet të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

---

## 2 Pasqyrat vjetore financiare

Rishikimi ynë i pasqyrave vjetore financiare merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e konsiderojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e pasqyrave vjetore financiare përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave vjetore financiare. Një numër i pikëve në deklaratë kanë për qëllim të ofrojnë siguri për Qeverinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

### 2.1 Pajtueshmëria me kornizën raportuese

#### Konkluzioni i përgjithshëm

PVF ishin përgaditur në pajtim me kërkesat e Rregullës Financiare nr. 07/2011, dhe sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Agjencia ka përdorur formatin standard për raportim, dhe ka plotësuar të gjitha kërkesat në pajtueshmëri me kornizën për raportim.

#### Përshkrimi

Pasqyra vjetore duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuara raportuese. Ne kemi vërejtur se:

- PVF janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave (MF);
- PVF janë nënshkruar nga ZKA dhe ZKF;
- PVF janë pranuar në gjuhën shqipe; dhe
- PVF janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto. Çështjet e ngritura gjatë auditimit të 9 mujorit në lidhje me kornizën raportuese në memon tonë të datës 14/12/2012 janë adresuar nga Menaxhmenti.

#### Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.



---

## 2.2 Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare

### Konkluzioni i përgjithshëm

Kemi analizuar cilësinë e informatave të prezantuara në PVF, ne vlerësojmë se PVF janë të plota dhe të sakta. Megjithatë, Agjencia ka shpalosur vlerën e pasurive kapitale (mbi 1000€) në PVF 2012, mirëpo këto pasuri nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël në SIMFK. Për këtë arsye vlera e prezantuar në PVF nuk mund të mirret si plotësisht e besueshme (për më shumë shih nënkaptullin 4.5 Pasuritë).

### Përshkrimi

Si rezultat i auditimit tonë, janë bërë rregullime në draft pasqyra financiare të paraqitura për auditim. Arsyet kryesore për këto rregullime janë:

- Pasqyra financiare 1, neni 12 Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme nuk ishte paraqitur saktë vlera e shpenzimit.

Ne kemi dhënë edhe një numër sugjerimesh të tjera për të përmirësuar shpalosjet narrative dhe për të siguruar plotësinë e informacioneve shpjeguese të kërkuara në nenin e lartcekur.

Marrë parasysh atë më lart - Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, kur draft PVF-të janë dorëzuar në Qeveri mund të konsiderohen si jo të sakta.

### Rekomandimet

---

#### 1. Çështja - Procesi i prodhimit të pasqyrave - Prioriteti - I rëndësishëm

<b>E gjetura</b>	Draft Pasqyrat vjetore financiare dhe letrat shoqëruese të punës nuk ishin subjekt i rishikimit të menaxhmentit para se ato të prezantohen në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm. Kjo ka rezultuar në një numër gabimesh dhe lëshime të identifikuar në pasqyrat financiare të cilat mund të ishin theksuar nga Rishikimi i Menaxhmentit
<b>Rreziku</b>	Draft Pasqyrat vjetore financiare janë rishikuar nga ZAP dhe korigjuar nga ana e Agjencisë përndryshe do të ekzistonte rreziku për opinion të kualifikuar.
<b>Rekomandimi 1</b>	Të sigurojë që plani i prodhimit për PVF-të 2013 formalisht përfshin rishikimin menaxherial të draft pasqyrave.

---

## 2. Çështja - Mos prezantimi i korigjimit lidhur me pagat dhe mëditjet -Prioritet-të tjera

- E gjetura** Sipas Thesarit dhe PVF-ve shpenzimet për paga dhe mëditje ishin në vlerë prej 141,724€. Ndërsa shpenzimet e ndodhura, të mbështetura nga listat e pagave, ishin prej 143,686€. Arsye për këtë nënraportim ishte alokimi i pamjaftueshëm nga thesari i shtyrë nga planifikimi i rrjedhës së keshit nga vet Agjencia. Diferenca në vlerë prej 1,961€ është korigjuar nga thesari duke e rritur llogarinë e parasë së gatshme. Ky korigjim ishte bërë për të barazuar shpenzimet e pagave dhe mëditjeve me alokimin e mjeteve. Ky korigjim nuk ishte reflektuar edhe në PVF 2012.
- Rreziku** Mos shpalosja e informatave lidhur me paranë e gatshme dhe shpenzimet reale të pagave dhe mëditjeve ulë besueshmërin e autoriteteve përkatëse ndaj agjencisë. Kjo vlerë mbulohet nga buxheti i vitit 2013 për shpenzimet e vitit 2012. Megjithatë vlera prej 1,961€ nuk është materiale dhe nuk ndikon në opinionin e auditimit.
- Rekomandimi 2** Ne të ardhmen në rast të korigjimeve të tilla, të bëjë shpalosjet e duhura lidhur me shpenzimet reale të pagave dhe mëditjeve.

### 2.3 Opinioni i Auditimit

Pasqyrat financiare në të gjitha aspektet materiale paraqesin *një pamje të drejtë dhe të vërtetë*.

Opinionin e auditimit përfshin *Theksimin e çështjes* për shkak se Agjencia ka shpalosur vlerën e pasurive fikse në PVF, mirëpo pasuritë nuk i ka regjistruar në SIMFK. Kjo nuk ndikon në asnjë nga dy Pasqyrat Kryesore Financiare në pajtim me SNKSP (**ISSAI 400 Opinion i Pakualifikuar me Theksim të Çështjes**).

---

## 3 Rekomandimet e vitit paraprak

### **Përshkrimi**

Agjencia ka filluar të funksionoj si organizatë e pavarur që nga muaji qershor 2011. Ky është auditimi i parë nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

### **Rekomandimi**

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

## 4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

### 4.1 Hyrje

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale.

Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Megjithëse, në disa aspekte, siq është ai i menaxhimit të buxhetit ende ka nevojë për përmirësim. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjat e llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti.

### 4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

#### Konkluzioni i përgjithshëm

Realizimi i buxhetit prej 94% tregon performance të mirë. Megjithatë, gjatë planifikimit dhe realizimit të buxhetit për vitin 2012, Agjencinë e kishin përcjellur sfida buxhetore si pasojë e mungesës së aprovimeve të buxhetit shtesë nga organet përkatëse dhe një plani të mirëfillt të rrjedhës së parasë.

#### Përshkrimi

Ne kemi konsideruar burimin e fondeve buxhetore për Agjencinë, dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike . Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (ne euro)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2012 Realizimi	2011 Realizimi <sup>2</sup>
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>273,900</b>	<b>299,900</b>	<b>281,001</b>	<b>134,456</b>
Granti i Qeverisë-Buxheti	273,900	299,900	281,001	134,456

---

<sup>1</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

<sup>2</sup> Realizimi 2011- Agjencia ka filluar të funksionoj si organizatë e pavarur në muajin Qershor 2011.

Realizimi i buxhetit për vitin 2012 ishte 281,001€ apo 94% e buxhetit final. Financimi i buxhetit të Agjencisë është bërë vetëm nga granti qeveritar. Nga tabela më lartë shihet se buxheti fillestar në krahasim me buxhetin final është rritur (për më shumë shih informatat poshtë tabelës 2).

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (ne euro)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Realizimi	2011 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>273,900</b>	<b>299,900</b>	<b>281,001</b>	<b>134,456</b>
Pagat dhe Mëditjet	152,000	152,000	141,724	55,684
Mallrat dhe Shërbimet	86,900	111,078	105,619	77,691
Komunalitë	5,000	8,000	7,960	1,081
Investimet Kapitale	30,000	28,822	25,698	0

Buxheti fillestar në krahasim me buxhetin final është rritur për 26,000€. Nga kjo shumë 23,000€ janë ndarë për kategorinë investime kapitale për projektin “Pajisje për IT (softuer), dhe 3,000€ në kategorin shërbime komunale. Projekti për pajisje të IT nuk është realizuar për arsye se sipas agjencisë do të zhvendosen nga objekti privat në objekt shtetëror.

Meqënëse, kërkesa e agjencisë për buxhet shtesë në kategorin mallra dhe shërbime nuk ishte aprovuar, Agjencia kishte kërkuar transferimin e buxhetit nga kategoria investime kapitale në kategorin mallra dhe shërbime. Me vendimin e Qeverisë nr 04/101 të datës 14.11.2012, si dhe nr 10/108 të datës 14.12.2012 është transferuar vlera 24,178€ nga kategoria e investimeve kapitale në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

---

## Rekomandimi

---

### 3. Çështja - Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit - Prioriteti-i rëndësishëm

**E gjetura** Gjatë analizave të kryera lidhur me mënyrën e planifikimit dhe realizimit të buxhetit të agjencisë për vitin 2012 kemi vërejtur mangësit në vijim:

- Sipas planit të rrjedhës së parasë, Agjencia kishte planifikuar që tërë buxhetin e aprovuar për mallra dhe shërbimeve t'a shpenzoj deri në muajin Korrik 2012. Kjo, sipas tyre ishte bërë sepse me rishikim të buxhetit do të përfitonin buxhet shtesë. Gjatë rishikimit analitik kemi vërejturë që Agjencia në mungesë të buxhetit në muajin tetor kishte shpenzuar vetëm 710€, ndërsa për muajt në vijim kishte shfrytëzuar mjetet e transferuara nga investimet kapitale; dhe
- Thesari kishte proceduar pagesën e pagave për muajin dhjetor në vlerë prej 15,833€ përkundër faktit që buxheti i alokuar ishte 12,666€. Buxhet ky i alokuar sipas rrjedhës së parasë të përgatitur nga Agjencia. Ky ndryshim kishte ndodhur për shkak të pagesave të shtesave për punën jashtë orarit në muajin nëntor. ZKA kishte aprovuar shtesa për punë jashtë orarit dhe sektori i financave i kishte dërguar listat e pagave në MAP duke mos marr parasysh buxhetin e alokuar për muaj.

**Rreziku** Mos planifikimi i duhur i shpenzimeve si dhe aprovimi i vendimeve që kanë implikime buxhetore pa siguruar që mjete të mjaftueshme janë alokuar rrit rrezikun që Agjencia të mbetet pa mjete financiare në muajt e fundit të vitit.

**Rekomandimi 3** Të rishqyrtoj proceset ekzistuese buxhetore për të siguruar përmirësimin e planifikimit dhe dinamikën e realizimit të buxhetit. Si pjesë e këtij procesi, duhet të siguroj që rrjedha e parasë është përgatiturë duke u bazuar në buxhetin fillestarë të aprovuar dhe po ashtu dinamika e shpenzimit është planifikuar duke u bazuar në nevojat e Agjencisë për gjatë tërë vitit. Më tutje, Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të marr në konsideratë implikimet buxhetore që mund të pasojnë nga aprovimi i vendimeve menaxheriale.

---

## 4.3 Kërkesat e raportimit

### Konkluzioni i përgjithshëm

Agjencia ka përmbushur disa nga kërkesat për raportim të jashtëm.

### Përshkrim

Gjatë vitit 2012 Agjencia ka përmbushur përgjegjësitë për raportim të jashtëm si në vijim

- Kërkesa Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë; dhe
- Pyetëtori për verifikimin rrënjësor të menaxhimit financiar (kërkesë nga ZAP).

Agjencia nuk ka përmbushur përgjegjësitë për raportim të jashtëm si në vijim:

- Draft Plani dhe plani përfundimtar i prokurimit ;
- Raportet mbi borxhet e dorëzuar në MF; dhe
- Raportet mbi kontrollet e brendshme, duke përfshirë raportin e vetëvlerësimit.

### Rekomandimet

---

#### 4. Çështja - Mos përgatitja e planit të prokurimit -Prioriteti - i rëndësishëm

**E gjetura** Sipas Ligjit për Prokurim Publik 04/L-042 neni 8, kërkohet që secila organizatë buxhetore të përgatit planin fillestar dhe përfundimtarë të Prokurimit. Agjencia nuk ka përgatitur planin fillestar të prokurimit. Kuvendi i Republikës së Kosovës i ka udhëhequr procedurat e prokurimit në emër të Agjencisë.

**Rreziku** Mos përgatitja e planit të prokurimit mund të rrit rrezikun që Agjencia të dështoj të identifikoj furnizimet gjatë vitit të cilat do t'i mundësonin arritjen e objektivave në mënyrë më efikase.

**Rekomandimi 4** Pavarësisht faktit që procedurat udhëhiqen nga një autoritet tjetër, duhet të përgatit planin fillestar dhe përfundimtar të prokurimit me qëllim të identifikimit të furnizimeve gjatë vitit. Kjo njëherit do t'a lehtësonte bashkëpunimin mes Agjencisë dhe autoritetit i cili kryen procedurat e prokurimit.

---

## 5. Çështja - Mos dorëzimi i raporteve mbi borxhet në MF-Prioritet -I rëndësishëm

- E gjetura** Agjencia nuk ka dorëzuar raportet mbi borxhet në MF sipas Rr. Financiare (04/2011), për raportim të Organizatave buxhetore lidhur me obligimet e papaguara. Në shpалosjen e obligimeve të papaguara në PVF ne kemi vërejtur që Agjencia kishte obligime duke filluar nga muaji mars 2012 ( për më shumë shih nënkapitullin Trajtimi i borxheve).
- Rreziku** Mos përgatitja e raporteve mbi borxhet rrit rrezikun që borxhet të akumulohen dhe Agjencia mos të jetë në dijeni lidhur me vlerën e borxheve të akumuluar.
- Rekomandimi 5** Të siguroj që ka instaluar mekanizma monitorues për të siguruar që sektori i financave përgatit raporte mujore mbi borxhet e Agjencisë dhe të njëjtat dërgohen në MF në baza mujore.

## 6. Çështja - Mos plotësimi i deklaratave vetëvlerësuese- Prioriteti - tjera

- E gjetura** Agjencia nuk ka plotësuar deklaratat vetëvlerësuese të punës, kërkesë kjo e Njësisë Qendrore Harmonizuese për Menaxhim Financiar dhe Kontroll.
- Rreziku** Vetëvlerësimi është proces i cili do të siguronte menaxhmentin e Agjencisë një pasqyrë të përgjithshme për menaxhimin financiar dhe kontrollit.
- Rekomandimi 6** Të përgatiten raportet për vetëvlerësimin dhe kontrole të brendshme për të vlerësuar efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

## 4.4 Shpenzimet

### Konkluzion i përgjithshëm mbi shpenzimet

Agjencia ka kuptuar nevojën për funksionim të kontrolleve të forta në fushën e shpenzimeve. Megjithatë mangësitë e shpалosura brenda këtij kapitulli shfaqin nevojën e zhvillimit të mëtejshëm të këtyre kontrolleve me qëllim të eliminimit të tyre.



---

## 4.4.1 Prokurimi

### Përshkrimi

Meqë Agjencia është institucion i vogël është arritur një marrëveshje në mes Agjencisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës që procedurat e prokurimit në emër të Agjencisë t'i udhëheq kjo e fundit. Agjencia nuk ka përgatitur plan të prokurimit për vitin 2012.

Megjithatë për vitin 2012 ka arritur të nënshkruaj 6 kontrata në vlerë të përgjithshme prej 32,596€, ndërsa për furnizime tjera ka shfrytëzuar kontratat e Kuvendit si dhe të Ministrisë së Administratës Publike (MAP). Ne kemi testuar 4 procedura të prokurimit dhe 20 pagesa në vlerë prej 52,807€.

Rezultatet e testeve tona nuk kanë nxjerr në pah mangësi në zhvillimin, udhëheqjen e procedurave të prokurimit dhe ekzekutimin e kontratave. Megjithatë me qëllim të përmirësimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në këtë fushë, ne shpalosim mangësit si në vijim:

### Rekomandimi

---

#### 7. Çështja - Regjistrimi i shpenzimeve në kode ekonomike joadekuate - Prioriteti - tjera

**E gjetura** Pagesa për blerje të pajisjeve me vlerë 3,935€ është e regjistruar në kodin ekonomik 13509 Pajisje tjera (më pak se 1,000€). Pagesa ka të bëjë me blerjen e kompjuterëve dhe një makine fotokopjuese dhe është dashur të regjistrohen në kodin ekonomik 13503 - Kompjuterat (më pak se 1,000€) dhe kodin 13505 - Makina fotokopjuese (më pak se 1,000). Shpenzimet e tatimit në qira për vitin 2012 ishin në vlerë 3,965€. Këto shpenzime janë regjistruar në kodin ekonomik 14110 Qiraja për ndërtesa ndërsa është dashur të regjistrohen në kodin ekonomik 14510 Pagesa e tatimit në qira.

**Rreziku** Regjistrimi i shpenzimeve në kode ekonomike joadekuate paraqet pasqyrim të pasaktë të shpenzimeve.

**Rekomandimi 7** Të sigurojë që procedurat e reviduara janë futur për të siguruar që kontrollet janë shtuar në kuadër të sektorit të pagesave në mënyrë që shpenzimet të klasifikohen dhe regjistrohen në përputhje me planin kontabël të miratuar.

---

## 4.4.2 Shpenzimet tjera

### Përshkrim

Ne kemi testuar 10 pagesa në vlerë prej 6,441€, të blerjeve të cilat nuk shkojnë përmes procedurës së prokurimit.

### Rekomandimi

---

#### 8. Çështja - Mosmbyllja e avansit për udhëtime zyrtare-Prioritet- i rëndësishëm

**E gjetura** Avansi për udhëtim zyrtar i hapur me datë 25.06.2012 në vlerë 2,810€, nuk është mbyllur. Udhëzimi Administrativ 2004/07 për udhëtimet zyrtare kërkon që mbyllja e avansit të bëhet 15 ditë pas kthimit nga udhëtimi zyrtar. Avansi është paraqitur në PVF si avans i pa arsyetuar.

**Rreziku** Mosmbyllja e avansit edhe pas 6 muajve rrit dyshimin që paraja e marrur avans nuk është shfrytëzuar për qëllimet e dedikuara.

**Rekomandimi 8** Të rishikoj arsyet për mos mbylljen e avansit dhe të ndërmerr masa konkrete që paratë e shpenzuara janë arsyetuar me dokumente përkatëse dhe procedurat e duhura për mbyllje janë kryer.

#### 9. Çështja - Furnizim me mbushje të telefonave mobil pa kontratë - Prioriteti - i rëndësishëm

**E gjetura** Sipas rishikimeve analitike shpenzimet e telefonisë mobile për vitin 2012 janë 11,060€ ndërsa shpenzimet e telefonisë fikse janë 2,514€. Furnizimi me mbushje të telefonave mobil është bërë nga një operator ekonomik dhe pa ndonjë kontratë.

**Rreziku** Duke pasur parasysh se në Kosovë tani operojnë disa operator ekonomik që ofrojnë shërbime të mira dhe me çmime të favorshme, mënyra aktuale e furnizimit me mbushje të telefonave nuk i siguron agjencisë shërbime efektive, efikase dhe ekonomike.

**Rekomandimi 9** Të shqyrtoj mundësin e zhvillimit të procedurave të prokurimit në mënyrë që të siguroj shërbime efikase me çmime më të favorshme.

---

### 4.4.3 Kompensimet ( pagat dhe mëditjet)

#### Përshkrimi

Në kategorinë paga dhe mëditje Agjencia kishte buxhetuar shumën prej 152,000€, ndërsa ka shpenzuar 141,724€ ose shprehur në përqindje 93%. Agjencia për vitin 2012 kishte të aprovuar me buxhet 20 pozita, ndërsa aktualisht ka 17 të punësuar.

Ne kemi testuar transaksione për paga, procesin e rekrutimit, kemi krahasuar kontratat e punës dhe pagesat. Testimet tona kanë venë në pah si më poshtë:

#### Rekomandimet

---

#### 10. Çështja - Mosplotësimi i vendeve të punës - Prioriteti- i rëndësishëm

**E gjetura** Agjencia për vitin 2012 kishte të aprovuar me buxhet 20 pozita, ndërsa aktualisht ka 17 të punësuar.

**Rreziku** Mosplotësimi me staf i pozitive të lira shkakton vështirësi në realizimin e plotë të detyrave të Agjencisë.

**Rekomandimi 10** Të ndërmerren masat konkrete për plotësimin e vendeve të lira për të mundësuar funksionimin e plotë të Agjencisë.

#### 11. Çështja - Shtesat për punë jashtë orarit në kundërshtim me Ligjin për pagat e nëpunësve civil- Prioriteti- i rëndësishëm

**E gjetura** Agjencia në mungesë të stafit kishte angazhuar disa nga zyrtarët të punojnë jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës. Ne kemi vërejtur se puna jashtë orarit ishte e dokumentuar mirë dhe ishte aprovuar nga ZKA, mirëpo llogaritja e pagave nuk është bërë sipas Ligjit për pagat e nëpunësve civil. Agjencia gjatë kalkulimit nuk kishte përfshirë vlerën 30%.

**Rreziku** Kompenzimi për punën jashtë orarit është nënvlerësuar sepse ligji për pagat e parasheh që pagesa për punën jashtë orarit llogaritet për çdo orë të plotë pune, duke i shtuar edhe vlerën si vijon: 30% shtesë të pagës bazë për orë të plotë për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës.

**Rekomandimi 11** Puna jashtë orarit të llogaritet sipas ligjit për pagat e nëpunësve civil.

---

## 4.5 Pasuritë

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi pasuritë

Agjencia ka rekrutuar zyrtarin e pasurisë, dhe ka krijuar një regjistër të brendshëm i cili është në përputhje me kërkesat ligjore. Vlera e pasurive mbi 1,000€ është prezantuar saktë në PVF, megjithatë nuk është regjistruar në regjistrin kontabël (SIMFK). Pasuritë nën 1,000€ janë regjistruar në regjistrin e brendshëm (exel) dhe janë prezantuar në PVF.

## 4.6 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

### Përshkrimi

Në nenin 16 të PVF-ve 2012, Agjencia ka shpалosur vlerën e pasurive mbi 1,000€ në vlerë neto 24,000€, dhe ato nën 1,000€ në vlerë 26,000€. Agjencia kishte formuar komisionin e inventarizimit dhe ky komision kishte kryer punën për vitin 2012.

### Rekomandimi

---

#### 12. Çështja - Mos regjistrimi i pasurisë në SIMFK-Prioriteti - i rëndësishëm

**E gjetura** Gjatë vitit 2012 ka blerë 2 vetura në vlerë 25,698€. Veturat janë paraqitur në PVF mirëpo nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël (SIMFK). Kjo kishte ndodhur për arsye se zyrtari i pasurisë në agjenci nuk ishte i certifikuar për lejimin e qasjes në SIMFK.

**Rreziku** Regjistri kontabël (SIMFK) i Agjencisë nuk reflekton gjendjen e saktë lidhur me pasurinë në posedim. Vlera e pasurive është shpалosur në PVF megjithatë, SIMFK është sistem i besueshëm për menaxhimin e informatave financiare dhe për këtë vlera e pasurive e prezantuar në PVF nuk mund të mirret plotësisht e besueshme.

**Rekomandimi 12** Të ndërmerh hapat konkret për certifikimin e zyrtarit të pasurisë me qëllim që pasuritë mbi 1,000€ të regjistrohen në regjistrin kontabël (SIMFK).

---

## 4.7 Trajtimi i borxheve

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi trajtimin e borxheve

Ka prezantuar obligimet e papaguara në PVF. Mirëpo, nga faturat e papaguara të shpalosura në PVF vërehet se faturat nuk ishin paguar brenda afatit të përcaktuar ligjorë.

### Përshkrim

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2012 ishte në shumë prej 13,311€. Faturat lidhur me këto obligime datonin që nga muaji mars 2012. Pjesa më e madhe e faturave kishin të bënin lidhur me mallrat dhe shërbimet.

### Rekomandimet

---

#### 13. Çështja - Trajtimi i borxheve- Prioriteti - i rëndësishëm

**E gjetura** Agjencia kishte shpalosur faturat e papaguara gjatë vitit 2012 në PVF sipas kërkesave ligjore. Vlera e faturave të papaguara ishte 13,311€. Gjatë rishikimit kemi vërejtur që fatura në vlerë prej 597€ për servisimin e veturës ishte e muajit mars 2012, faturat e muajit shtator ishin në vlerë 527€, të muajit tetor 2,745€ dhe tjerat të muajve në vijim. Sipas LMFP-së të gjitha faturat duhet të paguhen brenda 30 ditëve pas pranimit të faturës.

**Rreziku** Buxheti i mbetur për mallra dhe shërbime në fund të vitit ishte në vlerë 5,559€. Kjo rrit rrezikun që agjencia të hyj në obligime pa siguruar që ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e tyre. Njëherit mos kryerja e obligimeve me kohë ulë besueshmërin e furnitorëve ndaj institucioneve publike.

**Rekomandimi 13** Paraprakisht, të siguroj që ka buxhet të mjaftueshëm dhe më pas të hyj në obligime, njëherit faturat t'i paguaj brenda 30 ditëve pas pranimit të faturës.

---

## 5 Sistemi i auditimit të brendshëm

### Përshkrimi

Agjencia për mbrojtjen e të dhënave nuk ka në funksion auditimin e brendshëm. Sipas U/A nr. 23/2009, Agjencia nuk plotëson kriteret për themelimin e NJAB-së. Megjithatë, udhëzimi i lartëpërmendur rregullon rastet kur organizatat nuk i plotësojnë kriteret për auditim të brendshëm dhe ofron mënyra tjera të sigurimit të këtyre shërbimeve.

### Rekomandimi

---

#### 14. Çështja - Shërbimet e Auditimit të Brendshëm -Prioriteti - i rëndësishëm

**E gjetura** Gjatë vitit 2012 Agjencia, nuk kishte bërë ndonjë kërkesë tek Njësia Qendrore Harmonizuese/ Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave apo në ndonjë institucion tjetër për shfrytëzimin e shërbimeve të auditimit të brendshëm. Andaj nuk kishte ndonjë raport për auditimin e brendshëm

**Rreziku** Auditimi i brendshëm do t'i ndihmonte menaxhmentit për identifikimin e fushave me rrezik dhe rishikimin e procedurave dhe proceseve me qëllim të arritjes së objektivave të institucionit.

**Rekomandimi 14** Ka marr në konsideratë lidhjen e një marrëveshje me ndonjë institucion të pavarur për shfrytëzimin e shërbimeve të Auditimit të brendshëm.

---

## 6 Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni ynë i përgjithshëm e pasqyron rishikimin e kontrolleve të ndërlidhura me PVF-të, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin të Sistemin e Auditimit të Brendshëm.

Në disa fusha të menaxhimit financiar Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror ka dizajnuar sisteme të kontrollit të brendshëm. Me qëllim të kryerjes së shërbimeve administrativo/financiare ka bërë delegimin e përgjegjësive dytësore tek stafi. Po ashtu ka një memorandum mirëkuptimi me Kuvendin e Republikës së Kosovës për realizimin e procedurave të prokurimit nga kjo e fundit në emër të Agjencisë.

Megjithatë, proceset dhe procedurat aktuale nuk kanë arritur të sigurojnë bazë të mirë për përdorim efektiv dhe efikas të parasë publike dhe që në të gjitha rastet të mbështesin vendimet e menaxhmentit.

Realizimi i buxhetit prej 94% tregon performance të mirë. Megjithatë, gjatë planifikimit dhe realizimit të buxhetit për vitin 2012, agjencinë e kishin përcjellur sfida buxhetore si pasojë e mungesës së një plani të mirëfillt të rrjedhës së parasë.

PVF ishin përgaditur në pajtim me kërkesat e Rregullës Financiare nr. 07/2011, dhe sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”, në përjashtim të pasurive fikse, vlera e të cilave ishte shpalosur mirëpo ato nuk janë regjistruar në SIMFK.

Mangësitë e shpalosura brenda këtij raporti duhet të adresohen nga menaxhmenti i Agjencisë për të siguruar se sistemet e kontrolleve janë zbatuar sipas synimeve të menaxhmentit.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një **opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.



---

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinion i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinion i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.